

NATIONS
United Nations
Interim Administration
Missionin Kosovo



Mission d'Administration
NATIONS UNIES
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Legjislatura-III

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Social
Mbledhja nr. 1
Prishtinë, më 12 shkurt 2008, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Social

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj , Slllobodan Petroviq, Teutë Hadri ,
Flora Brovina , Nurishahe Hulaj, Armend Zemaj, Gjylnaze Syla, Qamile Morina dhe
Mimoza Ahmetaj , ndërsa mungoj Bujar Bukoshi .

Nga Zyra e Presidentit të Kosovës , Nexhat Shatri
Nga OSBE- ja , Lejla Selimi
Nga NDI , Agron Demi
Nga zyra e komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj dhe Fatime Qorri

Mbledhjen e kryesoi z. **Sadik Idriz**, kryetar i Komisionit.

RENDI I DITËS

- 1. Konstituimi i Komisionit**
- 2. Të ndryshme.**

1. Konstituimi i Komisionit

Kryetari, ju uroj mirëseardhje deputetëve , anëtar të këtij komisioni dhe tha se së bashku do të kemi rezultate të mira dhe do të na ndihmoj edhe përvoja e deuterëve që më herët kanë qenë në të njëjtin Komision. Ky Komision mbulon dy ministri, atë të Shëndetësisë

dhe Ministrin e Punës dhe të Mirëqenies Sociale mirëpo shqyrton edhe çështje të cilat nuk janë në domenin e këtyre ministrive siç janë disa çështje të përbashkëta me Ministrin e Bujqësisë, do të përmendja Ligjin për Ushqimin . Kemi pas edhe një takim me kryetarin e Kuvendit lidhur me P/Ligjin e buxhetin i cili do të miratohet në procedurë të përsheptuar dhe lidhur me këtë P/Ligj do ti kemi edhe qëndrimet tona . Si prioritet në këtë përuhd do të kemi shqyrtimin e P/Ligjeve nga Pakoja e Ahtisarit ku Komisioni jonë do ti ketë në shqyrtim dy P/Ligje, atë për shëndetësi lokale dhe P/Ligji për pensionimin e parakohshëm të TMK së .

P/Ligjet do ti shqyrtojmë nen për nen dhe do të caktojmë raportues për çdo P/Ligj , dhe së shpejti do të përgatisim edhe një plan të punës.

Një numër më të madh të ligjeve do ta kemi nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe presim ndihmë edhe nga organizatat ndërkombëtare si NDI, AER-it etj.

Sa i përket komunikimit me media besoj se deklarata në emër të Komisionit do ti kemi me një dakordim të përbashkët .

Të bëjmë një prezentim, jam Sadik Idriz anëtar i GP 7+ , ish ministër i shëndetësisë, deputet në mandatin e tretë dhe tani kryetar i Komisionit , kam të kryer fakultetin e mësuesisë në Prizren .

Rita Hajzeraj, përshëndeti anëtarët e Komisionit dhe përshëndeti edhe punën e Komisionit në mandatin e kaluar dhe tha se ky Komision përfshin dy Ministri që kanë mjaft probleme dhe duhet të ballafaqohemi me ato probleme por besoj se do të gjejmë zgjidhje . Jam Rita Hajzeraj, vij nga AKR-ja jam nënkryetare e partisë dhe jam zëvendës shefe e grupit parlamentar . Kam të kryer fakultetin e mësuesisë dhe kam të regjistruar magjistraturën diplomaci dhe mardhënie ndërkombëtare . Do të jem një punëtore e denjë pa i përfshirë interesat partiake por do të punojë në interesin e përgjithshëm.

Sllobodan Petroviq, kryetar i partisë SLS dhe GP prej 8 anëtarësh dhe të përfaqësuar me dy ministra në Qeverinë e Kosovës. Jam anëtar edhe i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës dhe jam jurist me profesion. Besoj se kemi një përbërje të mirë të Komisionit dhe partia që përfaqësoj bën përpjekje të krijoj një jetë më të mirë në Kosovë pa marr parasysh përkatësin nacionale . I uroj punë të suksesshme Komisionit dhe do të punojmë në interesat e përgjithshme.

Mimoza Ahmetaj , stomatologe me profesion dhe në fund të specializimit në lëmin e Ortodontisë . Dëshiroj që bashkërisht të punojmë pa dallime, a jemi pozitë apo opozitë por të jemi në shërbim të popullit.

Armend Zemaj, deputet i LDK-së , anëtar edhe i Komisionit për Buxhet dhe Financa. Besoj se do të kemi një punë konstruktive në këtë Komision. Përkrah punën që është bërë në mandatin e kaluar por përveç sukseseve ka pas edhe mangësi të cilat në këtë legjislaturë ne duhet të punojmë që ti eliminojmë dhe besoj që do të punojmë në të mirë të qytetarëve të Kosovës . Besoj se do të kemi edhe një konsensus gjatë punës sonë.

Flora Brovina , me profesion mjekë dhe specialiste dhe kam të kryera studimet post diplomike . Në mandatin e par kanë qenë dy komisione, ai për shëndetësi dhe për çështje sociale ku kam qenë nënkryetare , ndërsa në mandatin e dytë janë bashkuar dhe kam qenë

anëtare e atij komisioni . Një nder problemet që ka mbetur pa u zgjedh ka qen miratimi i ligjit për ushqimin dhe ligjit për punën i cili është një ligj themelor. Do të njihemi me rekomandimet për shëndetësi që Komisioni i mandatit të kaluar i ka bërë dhe të përcjellim implementimin e tyre. Besoj se do të kemi një bashkëpunim të mirë dhe një punë të suksesshme së bashku.

Nurishahe Hulaj , jam doktoreshë, specialiste e shëndetësisë publike . Si Komision për shëndetësi kemi punuar bashkërisht dhe kemi shqyrtuar shumë ligje të rëndësishme . Kemi pas takime me ministrin përkatës dhe kemi pas bashkëpunim të mirë me NDI . Gjithashtu kemi kërkuar që ligjet e miratuara të implimentohen . Kërkoj nga ky Komision që të punojmë që qytetarëve të ju sjellim ligjin për çështje sociale , ligjin për personat me aftësi të kufizuara dhe ligjin për sigurime shëndetësore . Të kërkojmë nga Qeveria që të siguroj mjete që këto ligje të implimentohen.

Gjylnaze Sylja , vij nga AAK-ja . Që nga mbledhja e ardhshme mendoj se duhet ta kemi një plan të punës në bazë të cilit do të punojmë. Propozoj që mbledhjet ti mbajmë në orar të njëjtë të martën në orën 11 dhe mendoj se do të kemi një bashkëpunim të mirë .

Teuta Hadri, doktoreshë dhe deputete tash mandati i tretë.

Qamile Morine, përfaqësuese GP LDD , jam anesteziologe dhe punoj në QKUK . Nga raporti i vitit të kaluar pash që shumë ligje kanë kaluar nga lëmin e punës dhe mirëqenies sociale por shumë pak nga lëmi i shëndetësisë. Të gjithë e dimë që gjendja në shëndetësi është shumë e rënd andaj angazhimi jon do të duhej të ishte në ndryshimin e agjendës së deritashme të sistemit shëndetësor . Në planin e punës duhet të kemi prioritetet nga shëndetësia dhe shpresoj se do të punojmë të gjithë se bashku pa dallime partiake.

Kryetari, tha se për mbledhjen e ardhshme do të përgatitet një draft i planit të punës i cili do të plotësohet nga anëtarët e Komisionit . Si prioritet i kemi ligjet nga pakoja e Ahtisarit ku Komisioni jonë do ti ketë dy ligje . Do ti shqyrtojmë vetëm ligjet që do të shqyrtohen në lexim të par në Kuvend dhe do të bëjmë amendamentimin e tyre në Komision. Do të kemi edhe dëgjime publike për disa projektligje . Gjendjen në shëndetësi nuk mund ta ndryshoj komisioni por këtë mund ta bëj ministria . Ne do të bëjmë ligje të mira dhe kjo është detyra jonë dhe do të bëjmë monitorimin e zbatimit të ligjeve. Komisioni i mandatit të kaluar ka bërë më se 40 rekomandime për shëndetësinë dhe ne do të monitorojmë implementimin e tyre.

Armend Zemaj, propozoj që deri sa të vij strategjia legislative e Qeveris të bëhet një plan i punës së paku për tre muajt e parë.

Flora Brovina propozoj që disa ligje që janë përfunduar nga Komisioni në mandatin e kaluar por që nuk janë miratuar në Kuvend mund të rishikohen dhe janë në fazën përfundimtare të punës.

Gjylnaze Sylja tha se sipas rregullores së punës çdo punë e pa përfunduar fillon prej fillimit nëse nuk merr vendim Kuvendi ndryshe dhe pasi Kuvendi nuk ka marr ndonjë

vendim, formalisht punë duhet ti bëjmë nga fillimi. Ne kemi të drejt ti shqyrtojmë ligjet edhe para leximit të par në Kuvend , rregullorja nuk e pengon këtë në mënyrë që mos të miratohet ligji në lexim të par e pastaj të kthehet në ripunim në Qeveri pra Komisioni mund të bëj rekomandim edhe para leximit të parë. Qeveria është dashtë kur është zgjedh të sjell një plan legjislativ dhe kjo është një pengesë mirëpo ne mund të fillojmë edhe me çështje të tjera dhe shpresoj që së shpejti do të kemi edhe një plan të punës.

Kryetari tha se strategjia legjislative do të na ndihmonte në planin e punës por ne do të bëjmë përpjekje që në mbledhjen e ardhshme ta kemi draftin e par të planit të punës .

Ministria e shëndetësisë gjatë mandatit të kaluar ka paraqit një numër të madh të ligjeve për miratim në Kuvend dhe për strategjinë legjislative të vitit 2008 nuk do të ketë shumë ligje të shëndetësisë më shumë do të ketë ligje nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Nga pakoja e Ahtisarit do të kemi për shqyrtim dy ligje atë për shëndetësinë lokale dhe ligjin për pensionimin e parakohshëm të TMK së.

Si më urgjente në këtë periudhë është shqyrtimi i P/Ligjit për buxhetin , ku ne në mbledhjen e ardhshme do ta shqyrtojmë dhe do të bëjmë ndonjë propozim ose amendament nëse kemi por komision funksional për këtë PL është Komisioni për Buxhet dhe Financa . Sa i përket shkresës që na ka ardhur nga BSPK- ja , për mjete buxhetore për implementimin e Kontratës Kolektive mendoj se zbatimi i Kontratës Kolektive ka implikime të mëdha buxhetore dhe nuk e di se sa ne mund të ndikojmë ne në këtë drejtim.

Mbledhja e radhës do të jetë të maten e ardhshme.

Mbledhja përfundoj në orën 12:10min.

Përgatitur nga
Zyra e Komisioneve të Kuvendit

Kryetari i Komisionit,
Sadik Idriz